



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2023:273714

Datë: 26.06.2024

Numri i dokumentit: 05862329

PKR.nr.371/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti për Krime të Rënda, Kryetari i trupit gjykues - gjyqtari Avni Sylja, me bashkëpunëtoren profesionale Valbone Musa Lajçi, në çështjen penale kundër të akuzuarve L.M dhe G.S, për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, te akuzuar me aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda, PP.I.nr.213/2023 të dt. 30.11.2023, në shqyrtimin fillestar publik, të mbajtur me datë 18.06.2024, në prezencën e përfaqësuesit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Prokurores së Shtetit Bukurije Gjonbalaj, të akuzuarit L.M dhe mbrojtësit të tij sipas detyres zyrtare Av. Ridvan Kajtazi, te akuzuarit G.S me mbrojtësin e tij sipas detyrës zyrtare Av. Murat Paqarada, në të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 26.06.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Te akuzuarit:

1. L.M nga i ati B. dhe e ëma S., e gjinisë S., i lindur me dt. ... në P., me vendbanim në lagjen B..., rruga "V.." Ndertesat e H. B. hy 6 numër , i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, punon si taksist, me gjendje të dobët ekonomike, me nr. personal 1..., shqiptar-shtetas i Republikës së Kosovës.

2. G.S nga i ati N. dhe e ëma A., e gjinisë H., i lindur me dt. .. në fshatin L..., me vendbanim në lagjen e spitalit, rruga "K." në P., i martuar, ka të kryer shkollën e mesme, punon si taksist, me gjendje të dobët ekonomike, me nr. personal 1..., shqiptar-shtetas i Republikës së Kosovës.

JANË FAJTORË

Për shkak se:

Me datë 04.05.2023, rrethë orës 03:30 minuta në rrugën “Fahri Fazliu”, te lokali ”Euro Goma”, në Prishtinë nga Policia e Kosovës është hasur një veturë taxi e parkuar e tipit “H...” me targa 01-..., të cilën e drejtonte i pandehuri G.S, ku në veturë së bashku me të ishte edhe i pandehuri L.M dhe dëshmitari – pasagjeri J.A, dhe gjatë kontrolles së automjetit të pandehurit G.S. në çantën e të pandehurit L.M është gjetur që paautorizim kanë poseduar me qëllim të shpërndarjes një qese me substancë narkotike Kanabise (Mariuan) me peshë neto 17.08-0.0001 e cila substancë janë shpallur si narkotike, ku sipas marrëveshjes paraprake i pandehuri G.i kishte siguruar personit NN nga i cili e kishte blerë substancën narkotike i pandehuri L..

- **me këtë të pandehurit në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.**

Andaj gjykata konform dispozitave të cituara më lartë dhe neneve 7, 17, 21, 38, 42, 43, 69 dhe 70 të KPRK-së, si dhe nenit 364 dhe 365 të KPPRK-së, e:

G J Y K O N

I. Të akuzuarin L. S. me Dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti i cili dënim do të ekzekutohet, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, si dhe;

II. Dënim me gjobë në shumë prej 300 (treqind) euro, të cilin dënim i akuzuari obligohet ta paguaj në afat prej 2 (dy) muajve në këste te barabarta, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

III. Të akuzuarin G.S me Dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti i cili dënim do të ekzekutohet, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, si dhe;

IV. Dënim me gjobë në shumë prej 300 (treqind) euro, të cilin dënim i akuzuari obligohet ta paguaj në afat prej 2 (dy) muajve në këste te barabarta, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse te akuzuarit nuk dëshirojnë apo nuk mundën ta paguajnë gjobën, gjykata konform nenit 43 par.3 të KPRK-së, do të zëvendësoj dënimin me gjobë me dënim me burgim ashtu që për një ditë burgim do t’ i llogaritet me 20 (njëzet) euro gjobë.

Obligohen te akuzuarit që t’i paguajnë të gjitha shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, në emër të paushallit gjyqësor secili veç e veç shumë prej 50.00 (pesëdhjetë) euro, ndërsa në emër të Fondit për mbrojtjen e viktimave të paguajnë secili veç e veç shumë prej 50.00 (pesëdhjetë) euro, të gjitha këto nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

URDHËR-URDHEROHET konfiskimi i përhershëm i sendeve dhe atë:

Në mbështetje të nenit 267 par. 5 të KPRK-së, dhe nenit 276 par. 2 nenpar.2.4 të KPPRK-se, ndaj të pandehurit urdhërohet edhe: Konfiskimi i sendeve dhe atë:

- Substanca narkotike e llojit marihuanë, me peshë të përgjithshme me peshë neto 17.08-0.0001;

-

Urdhërohet Policia e Kosovës sektori/njësia DKKO-DHTN1- Prishtinë, që pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi të bëjë shkatërrimin (asgjësimin) e sasisë së lartpërmendur të substancës narkotike të konfiskuar.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, pranë kësaj gjykate ka parashtruar aktakuzën PP.I.nr.213/2023, të datës 30.11.2023, me të cilën ka akuzuar të pandehurit L.M dhe G.S, për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale gjykata mbajti shqyrtimin fillestar më datë 18.06.2024 në të cilën ishin të pranishëm të akuzuarit L.M dhe mbrojtësit të tij sipas detyrës zyrtare Av. Ridvan Kajtazi, të akuzuarit G.S me mbrojtësin e tij sipas detyrës zyrtare Av.Murat Paqarada.

Në seancën e shqyrtimit fillestar Prokurori i Shtetit bëri leximin e aktakuzës, ku pas leximit të aktakuzës të akuzuarit, L.M dhe G.S u njoftuan nga gjykata me të drejtat e tyre në kuptim të nenit 241 par. 1 të KPPK-së, po ashtu u njoftua për pasojat dhe benefitet e pranimit të fajësisë.

I akuzuari L.M është deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, duke shtuar se i premtoi gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra të tilla penale, ka shprehur keqardhje dhe pendim të thellë për veprën që e ka kryer dhe ka lutur gjykatën që me rastin e shqiptimit të dënimit ti shqiptoj një dënim sa më të butë.

Po ashtu i akuzuari G.S është deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, duke shtuar se i premtoi gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra të tilla penale, ka shprehur keqardhje dhe pendim të thellë për veprën që e ka kryer dhe ka lutur gjykatën që me rastin e shqiptimit të dënimit ti shqiptoj një dënim sa më të butë.

Mbrojtësi i të akuzuarit L.M av. Ridvan Kajtazi lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit ka deklaruar se pranimi i fajësisë nga i pandehuri është bërë në konsultim me mua si mbrojtës, pasi që është informuar nga unë për benefitet dhe pasojat e pranimit të fajësisë, ky pranim është bërë me vullnetin e plotë dhe në përputhje me gjendjen faktike që janë në shkresat e lëndës, andaj si mbrojtje e lus gjykatën që ta aprovoi pranimin e fajësisë të paraparë me dispozitat e KPPRK-së. Ka shtuar se i mbrojturi im ka një moshë relativisht të re, nuk ka te kaluar kriminale, i njëjti ne te gjitha fazat si ne polici, prokurori edhe ne gjykatë e ka pranuar fajësinë, jeton me dy prind të cilën janë të sëmure, i vetmi mbajtës i familjes, ka propozuar gjykatës që me shqiptimin e dënimit ti shqiptoj një dënim në kohëzgjatje prej 6 muaj të cilin dënim me pëlqimin e të akuzuarit ti zëvendësoje me dënim me gjobë apo në rastin ma të rendë ti shqiptojë

dënim me kusht për një periudhë dy vjeçare duke marrë për bazë rrethanat lehtësuese. Krejt në fund nëse i shqiptohet një dënim me gjobë gjykata ti ketë parasysh rrethanat mbi gjendjen e dobët ekonomike dhe ketë dënim ta ndaj në dy ose tre këste.

Mbrojtësi i të akuzuarit G.S av. Murat Paqarada lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit ka deklaruar se pranimi i fajësisë nga i pandehuri është bërë në konsultim me mua si mbrojtës, pasi që është informuar nga unë për benefitet dhe pasojat e pranimi të fajësisë, ky pranim është bërë me vullnetin e plotë dhe në përputhje me gjendjen faktike që është në shkresat e lëndës, andaj si mbrojtje e lus gjykatën që ta aprovoi pranimin e fajësisë të paraparë me dispozitat e KPPRK-së. Ka shtuar se meqenëse i mbrojturi im e pranoi fajësinë e lusim gjykatën që te ketë parasysh ketë fakt dhe te merr për bazë rrethanat lehtësuese për zbutjen e dënimit për veprën penale që i ngarkohet. I njëjti siç u deklarua i premtun gjykatës se në te ardhmen nuk do të përsërisë vepra te tilla penale, e po ashtu i njëjti nuk ka rene ndesh me ligjin deri me tani.

Prokurorja e Shtetit ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve, pasi që konsideroi se te njëjtit mjaftueshëm janë konsultuar me mbrojtësit e tyre, po ashtu kanë kuptuar benefitet dhe pasojat e pranimi të fajësisë dhe se ky pranim është në përputhje të plotë me provat që gjinden në shkresat e lëndës, andaj i propozoi gjykatës që ta aprovoi një pranim të tillë dhe me rastin e matjes së shqiptimit të sanksionit penal ky fakt të merret si rrethanë lehtësuese pasi që te pandehurit edhe në të gjitha fazat tjera të procedurës e kanë pranuar fajësinë.

Pasi që gjykata konstatoi që te akuzuarit u deklaruan se e pranojnë në tërësi veprën penale me të cilën janë ngarkuar, që te akuzuarit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit, që pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga te akuzuarit, pranimi i fajësisë është bërë edhe pas konsultimit të mjaftueshëm edhe me mbrojtësin e tyre, që pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, konform nenit 242 par.6 të KPPRK-së, kryetari i trupit gjykues mori aktvendim me të cilin e aprovoi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve, pasi që vlerësoi se ky pranim ishte në përputhje të plotë edhe me provat tjera që gjenden në shkresat e lëndës, e që të gjitha këto në mënyrë të plotë dhe të argumentuar e vërtetojnë faktin se te pandehurit kanë kryer veprën penale për të cilën akuzohen, andaj gjykata nuk administroi provat, por vazhdoi me matjen e dënimit.

Nga thëniet e vet të akuzuarve në shqyrtimin fillestar te cilët u deklaruan se e pranojnë fajësinë u vërtetua se te njëjtit me datë, kohë dhe vend si në dispozitivin e aktakuzës së ngritur ndaj tyre kanë kryer veprën penale për të cilën akuzohen.

Po ashtu vërtetohet edhe nga shkresat e lëndës dhe nga provat materiale siç është: Raporti i policit, raporti i Agjencisë së Kosovës për Forenzike me nr.AKF-2023-2499/23-2335 i dt.24.08.2023, Vërtetimi i marrjes së sendeve i dt.04.05.2023, si dhe foto dokumentacioni i cili gjendet në shkresat e lëndës.

Gjatë matjes së dënimit ndaj të akuzuarit, gjykata i vlerësoj të tëra rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cilat ndikojnë në llojin dhe në lartësinë e dënimit konform nenit 69 dhe 70 të KPRK-

së. Andaj, gjykata si rrethana lehtësuese të akuzuarve i mori faktin e pranimit të fajësisë në shqyrtim fillestar, po ashtu gjykata mori për bazë edhe rrethanat personale të të dy të pandehurve, te njëjtit janë me gjendje të dobët ekonomike, e po ashtu me peshë të veçantë faktin se, para gjykatës, që të dy te pandehurit kanë shprehur pendim të thellë dhe kjo vërehej hapur, që do të thotë se pendimi i tyre ishte i sinqertë.

Ndërsa si rrethana rënduese për të akuzuarit gjeti, rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale, posaçërisht faktin se pasojat e këtyre veprave penale reflektohen më së shumti tek moshat e reja e kohëve të fundit edhe te personat e mitur, për të cilët ekziston rreziku potencial të bëhen të varur nga këto substanca narkotike e me këtë ta rrezikojnë seriozisht shëndetin e që kjo dukuri kohëve të fundit po shkakton një shqetësim në familje dhe në rrethin shoqëror.

Gjykata vlerëson se dënimi i shqiptuar në rastin konkret është i drejt dhe i ligjshëm, në harmoni me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarve, shkallën e rrezikshmërisë së veprës penale dhe me intensitetin e rrezikimit apo dëmit të shkaktuar. Po ashtu gjykata vlerëson se një dënim i tillë do të ndikoj në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen si dhe në rehabilitimin e tyre, në parandalimin e personave tjerë nga kryerja e veprave penale, si dhe në shprehjen e gjykimit shoqëror në raport me veprat penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit në shoqëri, duke ndikuar në këtë mënyrë në përmbushjen e qëllimit të dënimit, të paraparë në nenin 38 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushalli gjyqësor është marrë në pajtim me nenin 449 par.2 pika 2.6 të KPPRK-së.

Vendimi për shumën e të hollave në emër të Fondit për mbrojtjen e viktimave është marrë në pajtim me nenin 36 par.3, nënpar.3.2 të Ligjit nr. 0//L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi për konfiskimin e substancën narkotike është marrë në pajtim me neni 267 par 5 të KPRK-se, dhe nenit 276 par. 2 nen par. 2.4 të KPPRK-së.

Me sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti i Krimeve të Rënda
PKR.nr.371/2023, datë 26.06.2024

Bashkëpunëtoreshë profesionale
Valbone Musa Lajçi

Kryetari i trupit gjykues – gjyqtari
Avni Sylja

Numri i lëndës: 2023:273714
Datë: 26.06.2024
Numri i dokumentit: 05862329

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të të njëjtit, Gjykatës të Apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate.